

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

Ap-Kz 337/2010
02 gusht 2011

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosovës, në kolegjin e përbërë prej gjyqtarit të EULEX-it Charles Smith si Kryetar kolegji, gjyqtarit të EULEX-it Gerrit-Marc Sprenger dhe gjyqtares të Gjykatës Supreme Marije Ademi si anëtarë të kolegjit, me asistimin e Zyrtares Ligjore të EULEX-it Olivia Debaveye,

Në lëndën penale kundër të pandehurit **Ventur M.**, i biri i **[REDAKTUAR]** dhe **[REDAKTUAR]** i lindur më **[REDAKTUAR]** shkurt 1980 në fshatin Kosuriq, komuna e Pejës, me adresë të banimit në Pejë **[REDAKTUAR]** Myrte Zenel, nr. 14, Shqipëri Kosovës, me kushte të dobëta ekonomike, në paraburgim që nga 23 korrik 2010,

I dënuar nga Gjykata e Qarkut të Pejës më 23 korrik 2010 për veprën penale *Vrasje e Çastit* në kundërshtim të nenit 33 të Ligjit Penal të Kosovës ("LPK") për vrasjen e Xhafer Belegu të kryer më 23 gusht 2003 në Pejë,

Duke vepruar sipas ankesës të të pandehurit të paraqitur përmes avokatit të tij mbrojtës Zenel Mekaj më 15 tetor 2010 kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut të Pejës në lëndën nr. **P.nr. 29/08**, të datës 23 korrik 2010, ku gjykata shpalli të pandehurin fajtor dhe e dënoi atë me 8 vjet burgim,

Pas mbajtjes së seancës më 02 gusht 2011 e hapur për publik, në praninë e Prokurorit të Shtetit dhe avokatit mbrojtës Zenel Mekaj, dhe në mungesë të të pandehurit i cili nuk dëshiroi të marrë pjesë në seancë dhe pas këshillimit dhe votimit të mbajtur të njëjtën ditë më 02 gusht 2011,

Shpall këtë

AKTGJYKIM

Ankesa e paraqitur në emër të të pandehurit **V. M.** kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut të Pejës në lëndën P.nr. 29/08, të datës 23 korrik 2010, përmes kësaj REFUZOHET si e pabazuar.

Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut të Pejës vërtetohet në tërësi.

ARSYETIM

I. HISTORIA E PROCEDURËS

Aktakuza PP.nr. 437/03 është paraqitur më 21 nëntor 2003 nga Prokurori Publik i Qarkut kundër V [REDAKTUAR] M [REDAKTUAR] për veprën penale *Vrasje, Lëndime të Lehta Trupore, dhe Posedim i Paligjshëm i Armëve dhe Municionit* sepse më 23 gusht 2003, pas grindjes në mes të babait të tij dhe viktimës, me ç' rast viktimë ka shtënë në të atin e tij, ai qëllimisht vrau X [REDAKTUAR] B [REDAKTUAR] dhe goditi S [REDAKTUAR] H [REDAKTUAR], të motrën e viktimës.

Shqyrtimi i parë gjyqësor është mbajtur më 28 janar 2004. I pandehuri ishte liruar nga akuza *Vrasje* pasi që ishte provuar se ai kishte vepruar në mbrojtje të nevojshme por u dënua me akuzën *posedimi i paligjshëm i armëve* dhe me akuzën *lëndime të lehta trupore* kundër S [REDAKTUAR] H [REDAKTUAR]. Ai u dënua me 6 muaj burgim.

Pas ankesës së Prokurorit, Gjykata Supreme e Kosovës më 21 janar 2005 prishi aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut për lirim nga akuza e vrasjes dhe dërgoi lëndën prapa për rigjykim.

Shqyrtimi i dytë gjyqësor është mbajtur më 8 maj 2007. I pandehuri përsëri u lirua sepse ishte provuar se ai ka vepruar në mbrojtje të nevojshme.

Pas ankesës, Gjykata Supreme e Kosovës më 06 dhjetor 2007 vendosi të anuloi aktgjykimin dhe të dërgoi lëndën prapa për rigjykim.

Shqyrtimi i tretë gjyqësor është mbajtur më 2, 3, dhe 8 qershor 2010, 21, 22 dhe 23 korrik 2010 në Gjykatën e Qarkut të Pejës. Më parë lënda i ishte caktuar EULEX-it, prandaj kolegji prej 2 gjyqtarëve të EULEX-it dhe 1 gjyqtar vendor vendosen mbi këtë lëndë dhe më 23 korrik 2010 shpallën të pandehurin fajtor për *Vrasje e Çastit* dhe e dënuan me 8 vjet burgim. Akuza është ndryshuar nga Prokurori gjatë fjalës përfundimtare nga *Vrasje në Vrasje e Çastit*.

Ankesë është paraqitur nga i pandehuri përmes avokatit të tij mbrojtës Zenel Mekaj më 15 tetor 2010.

ZPSK parashtroi mendimin e saj më 24 nëntor 2010.

II. ANKESA E TË PANDEHURIT

I pandehuri paraqiti ankesë përmes avokatit të tij mbrojtës Zenel Mekaj më 15 tetor 2010.

Avokati mbrojtës pretendon se aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Pejë përmban:

- shkelje substanciale të procedurës penale
- vërtetim të gabuar të gjendjes faktike
- shkelje të ligjit penal
- vendim të gabuar mbi dënimin

II. 1. Shkelja substanciale e procedurës penale

Avokati mbrojtës pretendon se dispozitivi është i paplotë dhe i pakuptueshëm. Dispozitivi nuk vërteton intensitetin dhe mënyrën e sulmit nga viktima X [REDAKTUAR] E [REDAKTUAR] ndaj R [REDAKTUAR] M [REDAKTUAR] (babai i të pandehurit), kështu që nuk mund të kuptohet qartazi reagimi i të pandehurit pasi kishte parë babanë e tij të jetë sulmuar.

Dispozitivi nuk specifikon se viktima qëllon në të babanë e të pandehurit katër herë por e lë të hapur mënyrën se si e sulmoi viktima babanë e të pandehurit prandaj është i paplotë dhe i pakuptueshëm.

II. 2 Gjendja faktike nuk është përcaktuar drejt

Gjykata e Qarkut nuk ka vlerësuar drejt arsyet pse V [REDAKTUAR] M [REDAKTUAR] qëndroi prapa qoshes së shtëpisë së viktimës dhe nuk morri parasysh versionin e të pandehurit se sapo kishte hyrë në oborrin e viktimës, viktima kishte qëlluar në drejtim të tij. Kjo është arsyeja pse i pandehuri ishte fshehur prapa murit për të mbrojtur veten. Gjykata e Qarkut konsideroi se ai ishte fshehur prapa qoshes me qëllim që të qëllonte viktimën pasi që dëshironte të merrte hak për babanë e tij.

Përveç kësaj, Gjykata e Qarkut nuk mori parasysh faktin se kishte shkëmbim zjarri në mes viktimës dhe të pandehurit, siç është konfirmuar nga dëshmitarja S [REDAKTUAR] H [REDAKTUAR]

Gjithashtu, Gjykata e Qarkut nuk mori parasysh se e shtëna e pestë e shkrepur nga viktima, (gëzhoja numër 7) ishte drejtuar në të pandehurin. Vendndodhja e kësaj gëzhoje sqaron se viktima ka shtënë në të pandehurin. Prandaj, i pandehuri reagoi ndaj kësaj të shtëne.

Në fund, mbrojtja pohon se është e mundur që viktima të ketë qëlluar më shumë se 5 herë, por nuk janë gjetur të gjitha gëzhojat, gjë që pastaj do ta sqaronte se viktima kishte qëlluar më shumë se njëherë në drejtim të të pandehurit. Megjithatë, Gjykata e Qarkut e mohoi tërësisht këtë mundësi.

II.3. Shkelja e ligjit penal në dëm të të pandehurit :

Gjykata e Qarkut nuk është dashur ta cilësojë veprën penale si *vrasje e çastit* nën Nenin 33 të LPK-së por si *vrasje në mbrojtje të domosdoshme*.

Vërtetimi i drejtë i gjendjes faktike do të kishte treguar se i pandehuri kishte vepruar në mbrojtje të domosdoshme, pasi që i pandehuri ishte i provokuar, ai u mundua ta mbrojë vetveten dhe verimet et tij ishin proporcionale.

Në përputhje me këtë, duhet të zbatohet Neni 9, paragrafi 1 i Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë ("KP RSFJ") sepse ky nen thotë se "*Vepra e kryer në mbrojtje të domosdoshme nuk konsiderohet vepër penale*". Avokati mbrojtës pretendon se i pandehuri duhet prandaj të lirohet pasi që ai veproi në mbrojtje të domosdoshme. Përpos kësaj, në përputhje me Nenin 9 paragrafin 3 të KP RSFJ-së, nëse kryesi tejkalon kufijtë e mbrojtjes së domosdoshme, gjykata mund të ulë dënimin, dhe nëse kryesi ka tejkalluar kufijtë për arsye të shqetësimit të madh apo frikës së shkaktuar nga sulmi, po ashtu mund të mos shqiptojë dënim ndaj tij.

Avokati mbrojtës kërkon që kjo duhet të zbatohet ndaj të pandehurit dhe prandaj dënimi duhet të zvogëlohet.

II.4. Vendimi mbi dënimin

Avokati mbrojtës pretendon se dënimi është shumë i ashpër. Vërtet, vepra penale *vrasje e çastit* është e dënueshme prej 1 deri në 10 vjet, në përputhje me LPK-së. Prandaj, dënimi me 8 vjet është gati dënim maksimal. Kjo nuk merr parasysh faktin se viktima e kishte qëlluar babanë e të pandehurit katër herë dhe se i pandehuri e kishte parë babanë e tij në gjunjë duke derdhur gjak.

Prandaj, avokati mbrojtës kërkon që aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Pejë të **ndryshohet** në mënyrë që të lirohet i pandehuri apo të shqiptohet një dënim më i butë ndaj tij ose **anullohet** dhe lënda të kthehet për rigjykim dhe për një vendim të ri.

III. Mendimi i ZPSHK-së

Prokurori i Shtetit në Mendimin e vet të datës 23 nëntor 2010 propozon që ankesa e avokatit mbrojtës të V. M. të refuzohet si e pabazuar dhe të vërtetohet aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Pejë për këto arsye:.

- Dispozitivi është i kuptueshëm dh përshkrimi faktik është në pajtim me provat;
- Gjendja faktike është vërtetuar drejt;
- Gjykata ka ofruar arsyetim të hollësishëm dhe vlerësim të provave në aktgjykim, siç janë dëshmitarët dhe raportet e vendngjarjes;
- Prokurori i Shtetit konsideron se ky nuk është rast i vetëmbrojtjes në përputhje me Nenin 8 të KPK-së sepse kur i pandehuri e qëlloi viktimën, ai nuk ishte i sulmuar nga viktima dhe ai vrapoi pas viktimës për ta vlarë atë. Pra nuk kishte asnjë sulm të paligjshëm, real dhe të pashmangshëm kundër të pandehurit. Kjo nuk mund të cilësohet as si tejkallim i vetëmbrojtjes pasi që elementi parë i vetëmbrojtjes p.sh. sulmi i pashmangshëm nuk plotësohet.
- Ky është një rast i qartë i vrasjes së çastit. Vepra penale është ri cilësuar në mënyrë adekuate.

- Prokurori i Shtetit beson dënimi me 8 vjet është adekuat.

IV GJETJET E GJYKATËS

IV.1. Pranueshmëria e ankesës

Gjykata Supreme gjen se ankesa në emër të të pandehurit është e paraqitur me kohë dhe prandaj është e pranueshme. Aktgjykimi i ankimuar i është dorëzuar të pandehurit më 18 tetor 2010 dhe avokatit mbrojtës më 8 tetor 2010 dhe ankesa është paraqitur më 15 tetor 2010, brenda afatit prej 15 ditësh të përcaktuar me Nenin 359 paragrafin 1 të Ligjit të Procedurës Penale ("LPP"). Ankesa është paraqitur nga Avokati mbrojtës, person i autorizuar.

IV.2 Shkelja substanciale e procedurës penale

Gjykata Supreme me kujdes mori parasysh në veçanti dispozitivin e aktgjykimit të Pejës të lëshuar më 23 korrik 2010 për të vlerësuar nëse kjo mund të konsiderohet si shkelje substanciale e procedurës penale nën nenin 364, paragrafin 1, nënparagrafin 11 të LPP-së. Gjykata Supreme tanimë ka diskutuar disa herë për përmbajtjen e dispozitivit¹ me qëllim të vlerësimit se a duhet të konsiderohet si i pakuptueshëm dispozitivi që përmban vetëm hollësi të kufizuara të fakteve dhe rrethanave të veprës penale në pyetje.

Dispozitivi i aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë të datës 23 korrik 2010 thotë si në vijim:

V . M . " [REDAKTUAR] SHPALLET FAJTOR për *Vrasje të çastit në kundërshtim me Nenin 33 të Ligjit Penal të Kosovës (LPK) për vrasjen e [REDAKTUAR] të kryer, më 23 gusht 2003, në Pejë, sepse pasi ishte pezmatuar, pa fajin e tij, nga një sulm i rëndë i kryer nga [REDAKTUAR] kundër [REDAKTUAR] babait të të pandehurit, ai ishte i provokuar t'ia merrte jetën [REDAKTUAR] dhe shtiu në të me pistoletë duke e qëlluar në tëmthin e [REDAKTUAR] parrmë të djathtë në mënyrë vdekjeprurëse, kështu duke i shkaktuar atij vdekjen.*" X . B . R . M . X . S .

Gjykata Supreme konsideron se ky dispozitiv i plotëson kushtet nga Neni 357 paragrafët 3 dhe 4 lidhur me Nenin 351 të LPP-së. Në të vërtetë, dispozitivi përmend emrin e viktimës, vendin dhe kohën e kryerjes së veprës penale, faktin se i pandehuri ka kryer veprën penale në gjendje të pezmatimit të shkaktuar nga sulmi i rëndë i viktimës ndaj babait të tij dhe provokimin rezultues për t'ia marrë jetën viktimës. Kolegji po ashtu vëren se dispozitat përkatëse ligjore janë përmendur. Avokati mbrojtës pohon se dispozitivi është i pakuptueshëm për shkak se nuk specifikon se viktimja kishte qëlluar babanë e të pandehurit katër herë, prandaj, nuk mund të kuptohet intensiteti i sulmit të pohuar dhe reagimi i të pandehurit. Sidoqoftë, në të kundërtën, Gjykata Supreme gjen se dispozitivi ofron informata të mjaftueshme sa i përket fakteve dhe rrethanave të cilat përbëjnë elementet e veprës penale dhe të atyre në bazë të cilave varet zbatimi i

¹ Aktgjykimi Ap-Kz 108/2010, I [REDAKTUAR] G [REDAKTUAR] 25 nëntor 2010, Aktgjykimi Ap-Kz 128/2010, F.B, 3 gusht 2010, Aktgjykimi Ap.-Kz. Nr. 89/2010, I [REDAKTUAR] G [REDAKTUAR] e të tjerët 26 janar 2011

dispozitës së caktuar, siç kërkohet me nenin 351 të LPK-së. Fakti se nuk është cekur në mënyrë të qartë se viktima ka shtënë në babin e të pandehurit katër herë nuk e bën dispozitivin të pakuptueshëm.

Për më tepër, siç është theksuar më parë nga Gjykata Supreme, një aktgjykim duhet të konsiderohet si dokument unik i përbërë prej tri pjesëve: hyrjes, dispozitivit dhe arsytimit sipas nenit 357 paragrafit 1 të LPK-së. Pasi që dispozitivi është pjesë integrale (dhe më e rëndësishmja) e aktgjykimit, duhet të lexohet dhe interpretohet në lidhje me të gjitha pjesët tjera të aktgjykimit.

Në të njëjtin arsyetim të aktgjykimit është sqaruar mjaft mirë se viktima X B para se është vrarë ka shtënë në R M babai i të pandehurit, duke i shkaktuar atij pesë plagë dhe kjo në veçanti sqarohet në detaje në faqet 12, 17, 22 të aktgjykimit (në versionin në gjuhën angleze).

Prandaj, kolegji vendos që ta refuzojë këtë bazë të ankesës pasi që Gjykata e Qarkut në Pejë nuk e ka shkelur procedurën penale në mënyrë substanciale.

IV.3 Vërtetimi i gabuar i gjendjes faktike

Kolegji ka shqyrtuar me kujdes përshkrimin e ngjarjeve siç është dhënë nga dëshmitarët dhe në raporte dhe dëshmi të dëshmitarëve ekspertë² e përmbledhur në faqet 6 deri në 10 të aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë, në bazë të këtyre pikave:

- Marrëdhëniet në mes të familjes M dhe familjes E
- Ngatërresa në lidhje me gropën në rrugën në mes të dy shtëpive dhe të shtënat nga X B;
- Reagimi i të pandehurit dhe vrasje e X B
- Ngjarjes menjëherë pas të shtënave.

Kolegji gjen se Gjykata e Qarkut në Pejë ka bërë një prezantim të arsyetuar mirë të gjetjeve faktike në faqen 12 dhe ka diskutuar versionet e mundshme të ngjarjeve në mënyrë të konstatojë përfundimisht në faqen 17 se: "Prandaj, duhet të vërtetohet se pas 4 të shtënave kundër R X ka shkuar në drejtim të shtëpisë së tij, pastaj ka shtënë edhe një herë (me siguri kundër dhe pasi që i janë harxhuar plumbat ai ka shkuar në drejtim të garazhit dhe pas shtëpisë kur Ventori ka hyrë në oborrin e viktimës, është fshehur pas shtyllës së shtëpisë, i ka thënë fjalët e lartpërmendura dhe e ka qëlluar në gjoks me plumbin vdekjeprurës."

Është e qartë se gjykata e shkallës së parë e ka konsideruar versionin e paraqitur nga i pandehuri se ai është fshehur pas shtyllës në mënyrë që të mbrohet nga të shtënat e pretenduara në drejtim të tij nga ana e viktimës. Mirëpo, kolegji i Gjykatës Supreme

² Shih faqet 4 dhe 5 të aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë të datës 23 korrik 2010 (versioni në gjuhën angleze)

pajtohet me qëndrimin e Gjykatës Supreme i cili sqaron në detaje arsyet se pse kjo teori është mohuar nga provat objektive se asnjë gëzhgjë e shpenzuar nga revolja e viktimës nuk janë gjetur në rrugicën e cila shpie tek garazhi, dhe nga gjasat e vogla se ka pasur të shtëna shtesë nga viktima mirëpo gëzhgjat nuk janë gjetur nga ana e policisë e cila ka arritur në vendin e ngjarjes pas 20 minutave.

Siç është theksuar në aktgjykimin V [REDAKTUAR] U [REDAKTUAR] R [REDAKTUAR] S [REDAKTUAR] dhe S [REDAKTUAR] I [REDAKTUAR] (Ap – Kz 428/2007 të datës 28 maj 2007),

“Gjykata Supreme e Kosovës duhet të pajtohet me vlerësimin e trupit gjykues lidhur me kredibilitetin e dëshmitarëve të cilët janë paraqitur para tyre dhe të cilët kanë dëshmuar personalisht para tyre. Nuk është e përshtatshme që Gjykata Supreme e Kosovës ta refuzojë vlerësimin e trupit gjykues në lidhje me kredibilitetin e atyre dëshmitarëve përveç nëse ekziston bazë e fuqishme për të vepruar në atë mënyrë”.

Kjo gjithashtu vlen edhe në këtë lëndë. Nuk ka arsye të vlefshme ose fakte plotësuese dhe prova të prezantuara nga avokati mbrojtës të cilat janë të mjaftueshme për ta refuzuar përfundimin e bërë nga Gjykata e Qarkut në Pejë.

Prandaj, kolegji i Gjykatës Supreme nuk ka gjetur se gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të gabuar ose jo të plotë dhe se gjykata nuk ka vërtetuar në mënyrë të gabuar disa fakte ose nuk i ka vërtetuar siç është paraparë me nenin 366 të LPK-së.

IV.4 Shkelja e ligjit penal

Cilësimi juridik i veprës penale në fjalë vjen pas vërtetimit të gjendjes faktike.

Gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se i pandehuri nuk ka shtënë në mënyrë që të mbrohet nga sulmi i pashmangshëm, mirëpo ka hyrë në oborrin e viktimës, është fshehur dhe ka shtënë në viktimën. Është konstatuar se veprimet e të pandehurit nuk mund të shpjegohen si një akt i mbrojtjes së domosdoshme pasi që sulmi kundër babit të pandehurit ka përfunduar dhe nuk është provuar se ka pasur sulm nga viktima kundër të pandehurit.

Ky qëndrim është në përputhje me udhëzimet e përcaktuara në aktvendimin e Gjykatës Supreme të datës 6 dhjetor 2007 ku lënda është kthyer për rigjykim dhe rivendosje: *“Prandaj, përfundimi i gjykatës së shkallës së dytë se në këtë lëndë ka të bëjë me veprën penale vrasje nga mbrojtja e domosdoshme sipas nenit 30 paragrafit 1 të LPK-së në lidhje me nenin 9 paragrafët 1 dhe 2 të KP RSFJ-së nuk mund të pranohet për arsye se nuk ka ngjashmëri me veprimet e të akuzuarit, prandaj një konstatim i tillë është në kundërshtim me provat e administruara.”* Kjo pikë tanimë është ngritur në aktvendimin e parë të Gjykatës Supreme të datës 27 janar 2005, i cili gjithashtu e kishte kthyer lëndën në rigjykim dhe vendim të ri herën e parë. Kolegji tanimë ka kritikuar gjykatën e shkallës së parë për vërtetim jo korrekt të gjendjes faktike e cila ka shpie në shkelje të ligjit penal:

pohimi se viktima ka shtënë në të pandehurin nuk është e vërtetuar me gjetjet e raportit balistik.

Gjykata Supreme pajtohet me gjykatën e shkallës së parë se neni 8 i Kodit Penal të Kosovës është më i favorshëm se neni 9 i Kodit Penal të RSFJ-së. Sidoqoftë, neni 8 i Kodit Penal të Kosovës kërkon “sulm të kundërligjshëm, real dhe të pashmangshëm” dhe neni 9 i Kodit Penal të RSFJ-së kërkon: “sulm të menjëhershëm dhe të kundërligjshëm”. Ky sulm i menjëhershëm dhe i kundërligjshëm nuk është vërtetuar në këtë lëndë. Gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë ka vërtetuar se ky nuk ka qenë akt i mbrojtjes së domosdoshme i cili do ta pamundësonte përgjegjësinë penale e as rast i tejkalimit të vetëmbrojtjes i cili do ta zvogëlonte dënimin.

Gjykata Supreme gjen se veprimet e të pandehurit janë ri-cilësuar në mënyrë adekuate nga Prokuroria Publike e Qarkut dhe Gjykata e Qarkut nga *vrasje* sipas nenit 30 të LPK-së në *vraje e çastit* sipas nenit 33 të LPK-së. Në të vërtetë, gjykata e shkallës së parë në mënyrë adekuate ka treguar se:

- kryerësi, në momentin kur e ka kryer veprën penale ka qenë në gjendje të zemëruar: kjo është konfirmuar nga dëshmitarët ekspert Dr. Nazife Sylejmani dhe Dr. Bujar Berisha në seancën gjyqësore të datës 21 korrik 2011, si dhe nga Dr. Gani Rana në dëshminë e tij të datës 23 dhjetor 2003;
- kryerësi pa fajin e tij është vënë në gjendje të tillë nga sulmi ose ofendimi i rëndë nga personi i vrarë: Është provuar përmes dëshmive të dëshmitarëve, ekzaminimit mjekësor të R. M. si dhe nga raporti i balistikës se viktima X. E. paraprakisht kishte shtënë katër herë në babin e të pandehurit. Ky nuk ka qenë faji i kryerësit pasi që ai ishte në shtëpinë e tij kur ka filluar zënka në mes të babait të tij dhe viktimës dhe kjo duhet të konsiderohet si një sulm i rëndë;
- prandaj, vrasja është provokuar: është treguar se pasi që e ka parë babanë e tij të mbuluar me gjak nga të shtënat e X. E. i pandehuri është provokuar që ta marrë jetën e viktimës.

Duke e pasur parasysh gjendjen faktike, Gjykata Supreme është e mendimit se gjykata e shkallës së parë e ka cilësuar në mënyrë adekuate veprën penale në fjalë si vrasje e çastit sipas nenit 33 të LPK-së, dhe prandaj nuk ka bërë shkelje të ligjit penal.

IV.5 Dënimi

Kolegji i Gjykatës Supreme gjithashtu konsideron se akti në fjalë në veçanti është i rëndë dhe si i pandehuri e ka ndjekur viktimën pas provokimit në mënyrë që ta qëlloj atë dhe në efekt ka marrë ligjin në duart e veta kur në fakt ai lehtësisht ka mundur ta kontaktoj policinë për ta arrestuar dhe hetuar viktimën.

Për këto arsye, Gjykata Supreme vëren se dënimi bie brenda kornizës ligjore pasi që vrasje e çastit është e dënueshme prej 1 deri në 10 vjet burgim sipas nenit 33 të LPK-së, dhe nuk konsideron se dënimi i shqiptuar nga trupi gjykues është i tepruar.

IV.6 Vlerësimi sipas detyrës zyrtare i shkeljeve sipas nenit 376 të LPK-së.

Përveç bazave të specifikuara në ankesën e avokatit mbrojtës, Gjykata Supreme gjithashtu ka për obligim sipas detyrës zyrtare që të analizojë:

- nëse ka pasur shkelje të dispozitave të procedurës penale të përcaktuara me nenin 364, paragrafin 1, pikat 1, 5, 6, 8 deri në 11 të LPK-së;
- nëse shqyrtimi gjyqësor është mbajtur në mungesë të të akuzuarit në kundërshtim të dispozitave të LPK-së;
- në rast të mbrojtjes së domosdoshme, nëse shqyrtimi gjyqësor është mbajtur në mungesë të avokatit mbrojtës të të akuzuarit;
- nëse ligji penal (neni 365) është shkelur në dëm të të akuzuarit.

Nuk është vërejtur asnjë shkelje e tillë.

V. PËRFUNDIM

Prandaj, është vendosur si në dispozitiv.

Përgatitur në gjuhën angleze, gjuhë zyrtare.

Ap-Kz. 337/2010

Sot më 2 gusht 2011

Kryetar i kolegjit

Charles L. Smith III

Procesmbajtëse

Olivia Debaveye

Anëtar i kolegjit

Gerrit-Marc Sprenger

Anëtare e kolegjit

Marije Ademi